

Antibiotikët në ushqime

Antibiotikët janë të rëndësishme për parandalimin dhe trajtimin e sëmundjeve në njerëz dhe kafshë. Antibiotikët gjithashtu zvogëlojnë mundësinë e transmetimit bakterial nga kafshët tek njerëzit. Agjencioni për Administrimin e Ushqimit dhe Medikamenteve (FDA) aprovon përdorimin e antibiotikëve në kafshë dhe në shpezë. Përdorimi në mënyrë të papërshtatshme mund të shkaktojë dëme dhe për këtë arsye veterinerët punojnë me fermerët, në mënyrë të vazhdueshme, që të përdorin këto produkte që sigurojnë konsumatorët me ushqim të sigurt.



Disa nga qëllimet kryesore të përdorimit të antibiotikëve janë klasifikuar mëposht:

1. *Trajtimin e sëmundjeve* (përdorim terapeutik). Kur një numër i vogël i kafshëve janë të sëmura në një tufë, bëhet trajtimi me antibiotik i të gjithë tufës për të parandaluar shpërndarjen e sëmundjes. Zakonisht bëhen 3 trajtime në doza të larta për një periudhë relativisht të shkurtër kohe;
2. *Parandalimin e sëmundjeve*: trajtimi i kafshëve me një dozë të ulët të antibiotikut në ushqim ose ujin e pijshëm, kur në kafshë nuk shfaqen shenja të sëmundjes por mendohet të jetë një rrezik i infeksionit. Trajtimi mund të jetë për një periudhë prej disa javësh, dhe nganjëherë më të gjatë.
3. *"Nxitjen e rritjes"* Një dozë shumë e ulët e antibiotikëve janë dhënë për kafshët (sidomos shpendëve) në ushqimin e tyre, fillimisht për rritjen e tyre dhe produktivitetit. Trajtimi është i vazhdueshëm dhe mund të zgjasë për një periudhë të gjatë të jetës së kafshës. Antibiotikët më të rëndësishëm që përdoren në të ushqyerit e kafshëve shtëpiake janë: tetraciklinë, oksitetraciklini, virginomicini dhe flavomicini. Antibiotikët ndikojnë pozitivisht në të ushqyerit e viçave, posaçërisht te kategoritë që ushqehen me sasi të zvogëluara të qumështit, pasi që këto kategori e kanë të zhvilluar mikroflorën, sepse në këtë fazë ushqehen me ushqime voluminoze dhe të koncentruara.

Te kafshët që mbahen për mish (majmëri), shtimi i antibiotikëve ndikon pozitivisht në rritjen e masës trupore dhe zvogëlon harxhimin e ushqimit, gjithashtu antibiotikët ndikojnë në shtimin e prodhimit të qumështit.



Pavarësisht rrugës së futjes së antibiotikëve në organizmin e kafshës ekziston një dozë e rrezikut të deponimit të antibiotikëve në produktet blegtorale (qumësht, mish, vezë) dhe të veprimit të dëmshëm në organizmin e njeriut si shfaqja e alergjive, skuqja dhe kruarja e lëkurës, astma, rezistence ndaj baktereve e cila pamundëson zbatimin efikas terapeutik të antibiotikëve në rast të infeksionit të njeriut.

Përmbajtja e antibiotikëve në qumësht paraqet problem në industrinë e përpunimit të qumështit pasi që ky llojë qumështit nuk i nënshtrohet procesit të fermentimit.

Qumështi i lopëve të sëmura ose kafshëve që trajtohen me antibiotikë nuk duhet të përdoret si qumështi i freskët apo për ndonjë produkt tjetër qumështi.

Ketu mire me shkru ndonje praktike ose diskutim per problemet ne industri te qumeshtit me antibiotike

Si një hap për parandalim është zhvillimi i një strategjije më efektive për përdorimin e antibiotikëve në bujqësi me qëllim të sigurimit se sasia e mbetje antibiotike të mos paraqet rrezik për shëndetin publik.